




“Plani Urbanistik i Integrimt per Qytetin e Vjeter te Durresit”/

”Old town Durres Master Plan”

“Piano Urbanistico Integrato della Città Vecchia di Durazzo”



Q.2 – Normat teknike te projektimit

Grupi i Projektimit:

Prof. Ing. Piero Rovigatti (kryetar grupi)

Prof. Arch. Carlo Pozzi

Prof. Ing. Enrico Spacone

Arch. Archh. Edmond Hali

Arch. Olta Brace

Ing. Enida Bitri

Keshilltare:

Gjeologjia: Prof. Nicola Sciarra, Fakulteti i Shkencave NN MM, Ud’A

Arkeologjia dhe rreziku arkeologjik: dott. Andrea Staffa;

Grupi operativ:

Ark. A. Buongiovanni

Ark. Massimo Di Francesco

Ark. Milena D’Urbano

Ark. Michele Palermo

Ark. Tiziana Percoco

Ark. Ippolita Ranù

Ark. Tiziana Pretara

Ark. Mirko Solazzo

TITULLI I – DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Neni 01 - Qellimi dhe Objektiva te pergjithshme
- Neni 02 – Perkufizime
- Neni 03 – Mbrojtja
- Neni 04 – Pjeset perberese te PACe
- Neni 05 – Vlera dhe kohezgjatja

TITULLI II – DREJTIME TE PERGJITHSHME
BAZE, DIMENSIONIMET DHE KUSHTET E ZHVILLIMIT

- Neni 06 – Vizioni Guide territoriale (tabela 01)
- Neni 07 – Zona e qendres se Duresit. Percaktimi i kufijve dhe gjendja faktike e vendeve (tabela 02)
- Neni 08 – Objektiva strategjike
- Neni 09 – Aseti i propozuar (tabela 03)
- Neni 10 – Pjeset urbane elementare. Objektivat lokale dhe dimensionet maksimale te pranueshme (tabela 04).
- Neni 11 – PUE A – Qendra historike
- Neni 12 – PUE B – Lagjet qendrore
- Neni 13 – PUE C – Lagjet veriore
- Neni 14 – PUE D – Zona bregdetare rreze-kodrinore
- Neni 15 – PUE E – Zona rreze-kodrinore e brendshme
- Neni 16 – PUE F – Vije bregdetare Lindore,
- Neni 17 – PUE G – Parku Bregdetar jugor
- Neni 18 – Zonat urbane elementare. Standartet minimale urbanistike baze (tabela 05).
- Neni 19 – Masat e ruajtjes dhe vleresimit te pasurise arkeologjike e kulturore (tabela 06)
- Neni 20 – Sistemi infrastrukturual dhe levizshmeria e qendrueshme (tabela 07)
- Neni 21 – Sistemi i qendrave te reja dhe te vendeve te kultures.

TITULLI III – PROJEKTE STRATEGJIKE

- Neni 22 – Kuadri i projektimit strategjik. Identifikimi.
- Neni 23 – APS 1 – Projekti i Zones Bregdetare Lindore
- Neni 24 - APS 2 – Projekti i Portit Turistik Moli Jugor
- Neni 25 - APS 3 – Projekti i Vijes Bregdetare Jugore
- Neni 26 - APS 4 – Projekti i Parkut territorial te Mureve Bizantine dhe te Viles se Mbretit Zog

Neni 27 - APS 5 – Projekti i Aksit Urban Rruga Epidamn
Neni 28 - APS 6 – Projekti i Aksit Urban Stacioni i Hekurudhor- Parku i Rezistences.
Neni 29 – Projekte shtese. Projekti per riintegrimin ndermjet qytetit dhe portit.

TITULLI IV – DISPOZITA TE ZBATIMIT

Neni 30 – Modalitetet e realizimit te Planit. Regjimet e transformimit
Neni 31 – Normativat dhe treguesit e pergjithshem per aplikimin e parimeve te ndarjes se drejte urbanistike ne zonat qe transformohen.
Neni 32 – Dispozita per formimin e Planit te Rikuperimit dhe te instrumentave te tjere per realizimin e Planit
Neni 33 – Kategorite e nderhyrjes te pranueshme ne ndertesa
Neni 34 – Kategorite e nderhyrjes te pranueshme ne hapesirat e lira.
Neni 35 – Profilet rregulluese planimetrike dhe altimetrike. Rregulla per ndertimin.
Neni 36 – Norma dhe matje urbanistike per zvogelimin e rrezikut sizmik dhe administrimin e emergjencave nga ngjarje te jashtezakonshme e te zakonshme
Neni 37 – Dispozita per administrimin e rrjeteve infrastrukturore

TITULLI V – KUADRI NJOHES DHE VLERESUES

Neni 38 - Sistemi informativ urban
Neni 39 – Procedurat e zbatimit dhe te administrimit
Neni 40 – Pergjegjesi dhe kompetenca

**Norma teknike te zbatimit te Planit Urbanistik te
Integrimit per Qytetin e Vjeter te Durrësit**

Titulli I – DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 01

Synime dhe Objektiva te pergjithshme

- 1.0. **Plani Urbanistik i Integritit per Qytetin e Vjeter te Duresit**, ne vazhdim percakton treguesit strategjike dhe dispozitat normative per qeverisjen e territorit te Bashkise se Duresit, brenda zones se planit te percaktuar ne perpunimin n. 2 – me titull “Zona Qendrore e qytetit te Duresit. Percaktime”
Ky plan perben variantin e Planit te Pergjithshem Rregullues ne fuqi, ne te cilin zevendesohen teresisht, normat e destinacionit te perdorimit te zonave, Normat Teknike te zbatimit, parashikimet e zhvillimit e karakteret dimensionale te vendbanimeve, si dhe cdo norme specifike qe lidhet me kete zone qendrore.
- 1.1 Plani i Ri i Duresit, kerkon te arrije nje zhvillim te qendrueshem te territorit. Ai synon rritjen e mireqenies se qytetareve, zvogelimin e pabarazive dhe shqetesimeve nga pikpamja urbane te shtresave me pak te privileguara te popullsisë si dhe zbutjen e rreziqeve (sizmike, hidro-gjeologjike, te ndotjes urbane e mjedisore). Ne te njejten kohe synon mbrojtjen e te drejtave te banoreve aktuale dhe te ardhshem per te perdorur ne liri te plote burimet themelore te territorit: driten, ajrin, truallin, gjelberimin dhe energjine. Nga kjo pikpamje, Plani kerkon te nderlidhe politikat komunale me ato sektoriale, duke perdorur edhe instrumentet e vleresimeve mjedisore e territoriale.
- 1.2 Plani i Ri merr persiper keto objektiva te pergjithshme.
- risistemimin, rishendoshjen, dhe rivleresimin e qytetit ekzistues. Kjo gje i referohet vecanerisht kujdesit dhe vleresimit te burimeve esenciale te territorit, te pejsazhit e te pasurive arkeologjike, kulturore e mjedisore.
 - Nxitjen e iniciativave strategjike per zhvillimin ekonomik e shoqeror. Ne vecanti kjo gje i drejtohet sistemit te infrastrukturave, zonave te qendrave te reja - terciare e drejtuese si dhe atyre te sherbimeve kolektive e turizmin.

1.3. Plani i Ri, i beson efikasitetin e tij pese ideve drejtuese. Realizimi i tyre eshte i lidhur me misionin qe ka si instrument operativ per zhvillimin ekonomik e shoqeror, per rivleresimin fizik dhe rilindjen urbane te qytetit.

- a. rishendoshja e lagjeve dhe pjeseve te demtuara te qytetit.
- b. sigurimi i qytetit, duke pershtatur qendrat e banuara e rrjetet e infrastruktures ekzistuese me kushtet me te mira te sigurimit te pergjithshem. Po ashtu te mbroje nga rreziku sizmik edhe sikur te kerkohen nderhyrje per pakesimin e vendbanimeve ekzistuese. Te merren masa per funksionimin normal te qytetit ne rastin e emergjencave per shkaqe natyrore apo edhe artificiale.
- c. terapia e hapesires: zhvillimi dhe rikuperimi i hapesirave publike te qytetit (zonat e gjelbera, sherbimet kolektive, zonat arkeologjike). Kjo gje edhe si veprim vleresimi te identiteve te shumfishta te nje qyteti me shume shtresa, i perbere nga shume qytete: qyteti arkeologjik, qyteti Bizantin, Venecian e Otoman, qyteti i Nenteqindes, qyteti bashkekohor;
- d. kujdesi per levizshmerine e qendrueshme: riorganizim i sistemeve te levizjeve, me perparesi sistemet e transportit kolektiv apo edhe te formave te tjera alternative te levizshmerise se qendrueshme;
- e. krijimi i qendrave te reja, duke i dhene rruge nje politike te zhvillimit te funksioneve te reja qendrore, terciare e drejtuese, te tille qe te mund te ndjeki transformimet e shpejta qe tani shkojne kryesisht drejt prodhimit te ndertimeve private te banimit.

1.3 Plani i Ri u hartua ne baze te parimeve te planifikimit dhe teknikave me te reja urbanistike, qe konsiston edhe ne nje zbatim eksperimental, si dhe te normativave urbanistike qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Ne vecanti nje Plan i tille u hartua ne baze te ligjeve qe rregullojne pronen private, organizimin territorial e mbrojtjen e trashegimisie kulturore te shtetit shqiptar:

1. Ligji n. 8405 i dates 17 Shtator 1998, "per planifikimin urban"/"for urban planning"/"per la pianificazione urbana";
2. Ligji n. 7664 i dates 21 Janar 1993 "per mbrojtjen e mjedisit" /"on environmental protection"/"per la protezione ambientale";
3. Ligji n. 7.665 i dates 21 Janar 1993, "per zhvillimin e zonave me perparesi turizmin"/"on the development of priorità areas concerning tourism"/"per lo sviluppo delle aree a priorità turistica";
4. Ligji n. 9.048 i dates 7 Prill 2003, "per trashegimine kulturore"/"for the Culturale Heritage"/"per il patrimonio culturale";
5. rregullimi I zbatimit te ligjit per planifikimin urban, n. 722 i dates 19 Nentor 1998, "Regolamento Urbanistico"/Rregullore e Urbanistikes" e Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit.

1.5 Plani perben nje rast per te interpretuar dhe aplikuar eksperimentalisht ligjin e ri per mbrojtjen e trashegimise kulturore n.722/98. Kjo gje eshte e lidhur me pervetesimin e parimeve themelore te Hartes se Rrezikut Arkeologjik te qytetit te Duresit; e hartuar nga Misioni Arkeologjik i Univesitetit te Parmes, drejtuar nga prof. Sara Santoro nga viti 2001 e deri ne vitin 2006.

- 1.6 Ne lidhje me problematikat qe ndeshen ne temen e lidhjes se qytetit, portit e Korridorit te VIII, Plani perben gjithashtu banko proven per politikat e reja te riintegrimit ndermjet qytetit e hapësires portuale.

Neni. 2 Perkufizime

Me qellim aplikimin e normave te Planit , i referohemi, perkufizimet e meposhtme qe dallohen per aspektet programatike, per orientimet e zbatimit, nderhyrjet dhe administrimin:

A *Aspektet programatike*

1 Qellimi dhe Objektivat e pergjithshme te Planit Urbanistike Integrimit per Qytetin e Vjeter te Duresit

Perfaqesojne qellimet baze qe orientojne formen dhe permbajtjen e Planit, ne perputhje me parimet e zhvillimit te qendrueshem te paraqitur ne nenin 1 te ketij teksti

2 Objektivat Strategjik (OS)

Perbejne projektimin ne hapësire te objektivate te pergjithshme duke iu referuar ndarjes se zones urbane qendrore, ne "Pjese Urbane Elementare"(PUE).

3 Objektivat Lokale (OL)

Shprehin nga pikpamja lokale objektivat strategjike te Planit, me referim ndarjen e zones se Planit, ne pjese urbane elementare.

4 Vizioni guide territoriale

Identifikon imazhin e perbashket te asetit te ardhshem te te gjithe territorit komunal, per t'u marre si guide sjelljeje nga administratat e ndryshme publike kompetente dhe subjektet e ndryshme publike dhe private te perfshire ne zbatimin e Planit.

6 Sistemi Territorial (ST)

Plani identifikon tipologjite e meposhtme te sistemit territorial:

sistemi i vendbanimeve dhe i infrastrukturave;

sistemi i zonave me dominim mjedisor;

Per secilin nga sistemet territoriale te identifikuar ne kete menyre, Plani percakton disiplina specifike ne perputhje me objektivat strategjike dhe lokale

7 Sistemi FunkSIONAL (SF)

Percakton nje strukture te mardhenieve ndermjet paleve, vendeve dhe srukturave te territorit, te karakterizuar nga aktivitetet dhe nga sherbimet qe per ndervaresine e tyre reciproke duhet te programohen organikisht dhe globalisht.

Plani konsideron si sisteme funksionale per t'u programuar bashkarisht te pakten ne nivel te territorit komunal, dhe se dyti ne nivel te zones qendrore te Duresit:

sistemi i portual

sistemi i levizshmerise,

sistemi i vendeve te arsimit

sistemi i siteve kulturore

sistemi i turizmit

ekosistemi dhe pejsazhi

8 Mjediset e Projektimit Strategjik (RrPS)

Mjediset e projektimit strategjik perbejne pjese te zones se qendres se Duresit, ne te cilen, Plani percakton nje funksion prioritar per arritjen e objektivave te tij strategjik lokal.

Ne pergjithesi koicidon me zonat ne gjendje te rende degradimi, por te vendosura ne pozicion strategjik kundrejt organizimit territorial te pergjithshem te qytetit dhe te rrethinave te tij gjeografike dhe territoriale.

9. Aksionet e transformimit

Aksionet e transformimit jane nderhyrje te parashikuara qarte ne Plan, realizimi i te cilave lejon modifikime te rendesishme te gjendjes se burimeve esenciale. Mbi keto aksione eshte e mundur te ushtrohen procedura te vleresimit nga pikpamja e masave parandaluese te efekteve territoriale dhe te produkteve mjedisore.

B. rekomandime per administrimin

10 Zona Urbane Qendrore

Zona qendrore urbane formon mjedisin e aplikimit te planit te tanishem. Kjo eshte identifikuar nga administrata bashkiake, dhe perputhet me perimetrin e dhene nga cdo tabele e planit, "si perimeter i zones qendrore".

11 Pjesa urbane elementare (PUE)

Perben nje nyje te sistemit territorial te vendbanimeve e te infrastrukturave ne zonen qendrore te Duresit. Ajo eshte percaktuar mbi bazen e kriterëve te homogjenitetit morfologjik, ambjental, te vendosjeve, social-ekonomike te tanishme apo te parashikuara ne territor. Dimensionin e saj eshte saktësuar ne funksion te objektivitetit per te garantuar kushte me te mira jetese te banoreve te saj. Per me teper duhet te siguroje kapacitete te pershtatshme per t'ju pergjigjur parashikimeve te zhvillimit te vendbanimeve, te infrastrukturave, te funksioneve e te sherbimeve te nevojshme.

Plani identifikon PUE dhe kufizimet e saj, percakton objektivat lokale (OL), dimensionet maksimale te pranueshme, drejtimet e karakterit pershkruar dhe tregues, duke ju referuar vendeve te dukshme qe permbajne monumente, zonave, ndertesave dhe komplekseve me interes arkeologjik, historik, artistik dhe te natyres, si dhe norma te tjera kufizuese dhe masat e nevojshme mbrojtese.

12 Pandryshueshmerite strukturale

Me qellim qe te garantohet zhvillim i qendrueshem dhe te ruhen burimet baze te territorit, Plani percakton pandryshueshmerite strukturale. Do te konsiderohen te tilla ato objektiva qe jane te detyrueshme per t'u ndjekur ne perputhje me vizionin e guides territoriale, sistemeve territoriale, sistemeve funksionale dhe te PUE.

13 Sitet kulturore

Percaktohen si site kulturore:

- a) vende ose itinerare me nje karakter te forte identiteti per komunitetin lokal;
- b) vende te qendrave te reja.

Ne secilin titull, keto tipologji te ndryshme te vendeve mbledhin deshmi te transmetuara nga e kaluara, ose qellime bashkimi e identifikimi kolektiv per te ardhmen. Sitet ndikojne ne percaktimin dhe ne vleresimin e identitetit lokal, dhe si te tilla do te jene objekt i nje disipline specifike nga ana e Planit.

14 Normativa

Perfshijne kompleksin e normave qe kane karakter bashkeadministrimi. Ne vecanti Plani percakton normativat me karakter drejtperdrejte rregullues dhe normativat detyruese per pjesen administruese te planit.

a). Normativat drejtperdrejte rregulluese

Jane lokalizime ne territor qe rrjedhin nga ligje, plane dhe programe te sektorit te nivelit mbikomunal, sic eshte parashikuar nga normativat e natyres shteterore ne fuqi.

Normativat drejtperdrejte rregulluese kane me shume force se sa dispozitat e instrumeteve urbanistike ne fuqi. Ato jane bashkeadministruese kundrejt subjekteve publike e private.

b). Normativat detyruese

Duhen konsideruar si normativa detyruese:

- pandryshueshmerite strukturale dhe percaktimi i tyre ne territor
- normat per ruajtjen e burimeve natyrore e kulturore, me referim te vecante ruajtjen e ujrave, trojeve dhe vendeve me interes dhe vlere kulturore.
- dimensionet maksimale te pranueshme te vendbanimeve dhe funksioneve.

15 Indikacione

Perbejne kompleksin e normave qe nuk vendosin detyrime te domosdoshme, por qe u sherbejne si orientim e drejtim subjekteve te ndryshme qe veprojne per transformimin e qytetit e keshu per pjesen administruese te PRG.

Indikacionet dallohen nga karakteri tipografik korsiv ne kete tekst.

16 Keshilla

Perbejne rekomandime qe u drejtohen subjekteve zbatuese per te permiresuar cilesine e rezultateve te veprimeve te parashikuara, ne interes te tyre si dhe ne interes kolektiv.

C. Regjimi i transformimit

17 Zona e nderhyrjes direkte

Jane vetem pjeset e zones urbane qendrore ose komplekse te vecanta ndertesash per te cilat parashikohet nje regjim i ruajtjes se gjendjes ekzistuese, i cili nuk sjell modifikime te medha te gjendjes se burimeve esenziale natyrore dhe ku megjithate aktiviteti i ndertimit, ndonese i kufizuar ne kategori te vecanta nderhyrjeje (mirembajtje te zakonshme, te jashtezakonshme dhe restaurimi), mund te kryhet ne forme direkte, pa kaluar ne formulim e aprovim te nje Plani urbanistik te detajuar.

18 Seksion urbanistik

Jane pjese te zones qendrore urbane, te identifikuara sakte ne Plan, ku cdo nderhyrje ndertimi kerkon krijimin e nje Konsorciumi per realizimin e Seksionit, te perbere nga pronaret e zonave dhe te pronave dhe formulimin dhe aprovimin e nje Plani urbanistik te detajuar. (Plani Urbanistik i Seksionit).

19 Zona te nderhyrjes strategjike

Jane pjeset e nje zone urbane qendrore, te identifikuara ne Plan, ku administrata bashkiake ka te drejte te promovojte nderhyrje te integruara publike – private, me qellim qe te realizojte objektivat e pergjithshme te Planit. Zonat e nderhyrjes strategjike krijojne nje nendarje te “kuadrove te projekteve strategjike”, te percaktuara e te prezantuara me pare.

20 Zonat e nenvendosura ne planin e rikuperimit bashkengjitur

Jane pjese e nje zone qendrore urbane, te identifikuara ne plan, ku ka nje plan rikuperimi, bashkengjitur Planit. Nje shembull i ketij tipi, te regjimit te transformimit te Planit, eshte Plani i rikuperimit te zones se amfiteatrit roman (fletorja Q,8 bashkengjitur planit).

21 Zona qe i nenshtrohen Planeve te rikuperimit

Jane pjese te zones urbane qendrore, te identifikuara ne Plan, ku zbatimi i cdo nderhyrjeje te rendesishme ndertimi kerkon formulimin dhe aprovimin e nje Plani te rikuperimit, te iniciatives publike ose private. Plani percakton ne detaje permbajtjen dhe procedurat te ketyre instrumentave zbatuese te Planit.

22 Hapesirat e nenshtrohen planeve te rikuperimit te mjedisit dhe urbanistikes

Percaktojne pjese te territorit bashkiak per te cilat objekti i ruajtjes kerkon nje kujdes aktiv te trashegimise se burimeve ekzistuese, dhe me aksione me qellim rivendosjen e ekuilibrave dhe vleresimin e cilesive mjedisore dhe panoramike ekzistuese. Cdo nderhyrje e rendesishme ndertimore ne brendesi te ketij kuadri te planit, kerkon formulimin dhe aprovimin e nje Plani urbanistik per rishendosjen dhe rikualifikimin mjedisor dhe panoramik te iniciatives publike (bashkiake)

23 Territori rural

Merret si territor rural teresia e pjeseve te jashtme te zonave te urbanizuara.

24 Zonat bujqesore

Konsiderohen zona bujqesore, zonat qe kane aktivitetete bujqesore, perfshire zonat e pakultivuara (te abandonuara ose djerr), te karakterizuara nga prania e specieve bimore dhe si te tilla te rikuperueshme per aktivitetete bujqesore. Nuk konsiderohen zona bujqesore zonat e abandonuara qe karakterizohen nga shkurre te perhershme apo nga gjelberim dinamik aktiv.

d. Kategorite e nderhyjes

1 Ndertesar

25 Ndertimet e reja

Konsiderohen si te tilla nderhyrjet ndertimore qe sjellin realizimin mbi toke te volumeve per seli aktivitetesh te cdo tipi, mbi troje te lira pa ndertime.

26 Mirembajtje te zakonshme

Konsiderohen te tilla, punime riparimi, rinovimi dhe zevendesimi te finiturave te ndertesave si dhe ato te nevojshme per integrimin ose mbajtjen ne eficence te impianteve teknologjike ekzistuese.

27 Mirembajtja e jashtezakonshme

Punimet dhe modifikimet e nevojshme per te rinovuar dhe zevendesuar edhe pjese strukturore te ndertesave, si dhe per te realizuar dhe integruar sherbimet higjeno-sanitare dhe teknologjike, gjithmone pa kaluar volumet dhe siperfaqet e njesive te vecanta te pasurive te paluejtshme dhe nuk sjellin modifikime te destinacionit te perdorimit.

28 Restaurimi dhe rishendosja konservative

Kompleksi i veprimeve ne drejtim te ruajtjes se organizmit te ndertimit dhe te siguroje funksionalitetin nepermjet nje teresie sistematike te punimeve, qe ne perputhje me elementet tipologjike, formale dhe strukturale te vete organizmit, lejojne destinacione perdorimi te krahasueshme me to. Te tilla nderhyrje perfshijne konsolidimin, kthimin ne gjendjen e meparshme dhe rinovimin e elementeve perberes te nderteses, futjen e elementeve ndihmes dhe impianteve te kerkuara nga nevojat e perdorimit, eleminimin e elementeve te huaj ne organizmin e nderteses originale.

29 Muzealizimi

Kompleksi i veprimeve ne drejtim te mbajtjes se pamjes origjinale te cdo ndertese ose vendi me interes kulturor, historik e artistik, duke e privuar nga perdorimi origjinal dhe duke e vene per shfrytezim kolektiv.

30 Restaurim tipologjik

Kompleksi i veprimeve per te risjelle nje organizem te vetem ndertimi ose nje grupi te tyre ne pamjen origjinale te tipit morfologjik.

31 Restaurimi konservativ (respektim tipologjik dhe konservimi i perdorimit origjinal)

Kompleksi i aksioneve te drejtuara ne konservimin e organizmit te ndertimit dhe sigurimin e funksionimit nepermjet nje teresie sistematike punimesh te cilat, duke respektuar elementet tipologjik, formale e strukturor te vet organizmit, mbajne destinacionin e perdorimit origjinal. Nderhyrje te tilla perfshijne konsolidimin, restaurimin dhe rinovimin e elementeve perberes te nderteses, futjen e elementeve ndihmes dhe te impianteve te kerkuara nga nevojat e perdorimit, si dhe eleminimin e elementeve te huaj ne organizmin e nderteses origjinale.

32 Ristrukturimi ndertimor me ruajtje te karaktereve te pergjithshem ballore.

Bashkesia e veprimeve ne drejtim te transformimit te organizmave ndertues nepermjet nje teresie sistematike te veprimeve, qe mund te sjellin ne nje organizem ndertimor teresisht apo pjeserisht ndryshme nga gjendja e meparshme. Nderhyrje te tilla perfshijne restaurimin ose zevendesimin e disa elementeve perberes te ndertimit, eliminimin, modifikimin dhe futjen e elementeve te rinj dhe te impianteve; gjithcka me kusht qe te mbahen te pa ndryshuara karakteret e pergjithshme (pjesa e fasades, numri dhe lokalizimi i hapjeve, materialet dhe grada e finiturave) te pjeses ballore.

33 Ristrukturimi ndertimor me nderhyrje ballore

Teresia e aksioneve ne drejtim te transformimit te organizmit ndertimor ndermjet nje bashkimi sistematik te punimeve qe mund t'i sjellin nje organizmi ndertimor ne te gjitha pjeset ose ne pjese te ndryshme nga ajo precedente. Nderhyrje te tilla permbajne permiresimin ose zevendesimin e disa elementeve perberes te nderteses, eliminimin, modifikimin dhe inserimin e elementeve te rinj dhe impianteve; te gjitha me mundesine e alternimit ne pjese te karaktereve te pergjithshme (pjeset e fasades, numrin e lokalizimit te hapjeve, materialet dhe gjendjen e rifiniturave) te pjeses ballore.

34 Shembje pa rikonstrukcion

Teresia e veprimeve per te eliminuar pranine e ndertimeve, pa asnje rikonstrukcion te tyre.

35 Rikonstrukcioni urbanistik

Teresia e nderhyrjeve qe behen per te zevendesuar rrjetin ekzistues urbanistik-ndertimor me nje gje tjeter te ndryshme nepermjet nje teresie sistematike te nderhyrjeve ndertimore edhe me modifikimin e dizenjose parcelave, te blloqeve e te rrjetit te rrugeve.

2 *Hapesra te lira*

36 Zona per t'ju nen shtruar nderhyrjeve te mirembajtjes

Konsiderohen te tilla zonat qe kane nevojte per punime, rinovimi dhe zevendesimin e elementeve urbane te detajuar qe e organizojne dhe e pasurojne si dhe qe rezultojne te nevojshme per te integruar ose mbajtur ne eficence impiantet teknologjike ekzistente.

37 Zonat e propozuara per nderhyrje restaurimi

Konsiderohen si te tilla zonat te cilat kane nevojte per veprime ne drejtim te ruajtjes se cilesise origjinale te zonave te tilla dhe te sigurojne funksionimin nepermjet nje teresie sistematike te punimeve ne perputhje me elementet tipologjike, formale dhe strukturale te organizimit fillestar, qe pranojne destinazione perdorimi te krahasueshme me to. Te tilla nderhyrje perfshijne konsolidimin, permiresimin dhe rinovimin e elementeve konstruktiv te zones, futjen e elementeve ndihmes dhe te impianteve te kerkuara nga nevojat e perdorimit, eliminimin e elementeve te huaj ne dizenjimin te zones origjinale.

38 Zona per t'ju nenshtruar nderhyrjeve per rishendoshje

Konsiderohen si te tilla zona te cilat kane nevoje per nderhyrje ne drejtim te eleminimit te kushteve te degradimit te rende mjedisor, urbanistik, higjeno-sanitar, prania e te clave mund te shkatoje demtim te vecante te jeteses se banoreve

39 Zonat e propozuara per nderhyrje te ristrukturimit urbanistik

Konsiderohen per te tilla, zonat qe kane nevoje per nderhyrje te lidhura me zevendesimin e dizenjove dhe asetete aktuale te zonave te tilla, por duke mbajtur kushtet e hapësirave te lira, ne pergjithesi te lira nga ndertimet, nese nuk eshte e tipit sekondar.

40 Zonat per t'ju nenshtruar nderhyrjeve qe i kerkojne norma teknike te vecanta

Konsiderohen te tilla zona, qe per nga cilesia dhe karakteristikat esenciale kane nevoje per nderhyrje qe kerkojne norma teknike te vecanta, si per shembull, per zonat arkeologjike, ose qe paraqesin nje grade shume te larte te rrezikut arkeologjik

e. materialet urbane

41 Ndertesarat

Volumet te ndertuara jashte tokes e qe i dedikohen aktiviteteve njerezore

42. Sheshet dhe hapësirat

Hapësirat e lira te karakterizuara nga nje perdorim publik, kryesisht per kembesore.

43 Rruget

Hapësirat e lira, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekt i normave specifike te perdorimit, kryesisht per kalimin e automjeteve publike dhe private

44 Parkimet

Hapësirat e lira, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekt i normave specifike te perdorimit, te dedikuara kryesisht per qendrimin e automjeteve publike dhe private.

45 Zonat e gjelbera publike

Hapësirat e pambuluara, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekt i normave specifike te perdorimit, te dedikuara kryesisht per perdorimi publik çlodhes

46 Mjetet publike urbane

Teresia e hapësirave dhe ndertesave, ose cdo komponent i vetem i kesaj teresie, selite e funksioneve ose te aktiviteteve publike, shpesh te zena nga ente apo struktura te sherbimit publik, qe lidhen me arsimimin, asistencen shendetesore, formimin kulturor, kultin, sportin, kohen e lire.

47 Rruget e bicikletave

Hapësirat e lira, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekti i normave specifike te perdorimit, te perdorura kryesisht per kalimin e bicikletave dhe motocikletave.

48 Rruget kembesore dhe trotuaret

Hapesirat e pambuluara, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekt i normave specifike te perdorimit, te perdorura per kalimin e kembesoreve.

49 Strukturat te levizshmerise publike

Hapesirat e lira, dhe aparatet teknologjike, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekt i normave specifike te perdorimit, te perdorura kryesisht per kalimin dhe sherbimin e sistemit te levizshmerise publike kolektive.

50 Struktura dhe elemente teknologjike urbane

Hapesirat e lira, dhe aparatet teknologjike, te percaktuara ne menyre te pershtateshme dhe objekti i normave specifike te perdorimit, te perdorura kryesisht per sherbime teknologjike urbane, ne lenden e energjise, furnizimin me uje, pastrimin e ujerave te zeza e te bardha, grumbullimin dhe perpunimin e mbetjeve te ngurta

51 Elemente te hollesishme urbane

Teresia e objekteve te vecanta dhe gjerave te nevojshme per dhenien e cilesise me te mire dhe funksionimin ne hapesiren publike urbane

52 Zonat arkeologjike

Pjese te truallit urban te karakterizuar nga prania e gjurmeve te te kaluares, te mbrojtura nga Shteti

53 Monumente

Teresia e objekteve, ndertesave, hapesirave te lira ose komponente te vecante te kesaj teresie qe paraqesin vlere dhe deshmi te se kaluares e qe jane motiv i identifikimit kolektiv.

f. ruajtja e trashegimise kulturore (ref.Nenit 3 Te LIGJIT n. 9048 te dates 17 prill 2003, Republika e Shqiperise)

54 “Kompleksi arkitektonik”

Eshte teresia e nje numri ndertesash, te cilat jane te lidhura se bashku me te njejtin koncept krijues.

55 Kompleksi historik:

Eshte teresia e vlerave urbanistike dhe arkitektonike me karakteristika historike

56 Kompleksi muzeal:

Eshte teresia e vlerave urbanistike dhe arkitektonike te mbrojtura nga Shteti.

57 Kompleksi urban: eshte teresia i vlerave urbanistike dhe arkitektonike ne nje qender qyteti, i cili mund te jete perbere nga nje ose me shume pjese te banueshme.

58 Kompleksi urbanistik-arkitektonik: i referohet nje qendre te banueshme, nese eshte bere sipas kriterave perberese te kaluares.

59 Arkitektura tradicionale: eshte arkitektura e te kaluares qe gjen sot nje shperndarje dhe nje praktike te perditeshme relativisht te shperndare.

- 60 Demtime: eshte nderhyrja materialisht ne menyre te demshme mbi trashegimine kulturore, duke i nderruar funksionimin ose pamjen origjinale.
- 61 Inventari: eshte rregjistrimi dhe identifikimi i objekteve qe i perkasin trashegimise kulturore.
- 62 Mbrojtja: eshte menyra dhe forma e natyres juridike ose me mire rikualifikimi, mbikqyrja, restaurami, konservimi i pasurise se trashegimise kulturore.
- 63 Monumenti i kultures: eshte nje objekti i nderuar, me vlere historiko- kulturore i mbrojtur nga Shteti.
- 64 Objekt ne mbrojtje paraprake: eshte nje komponent i trashegimise kulturore, materiale, ne pritje per t'u klasifikuar si monument kulture nga organet kompetente.
- 65 Objekti nen mbikqyrje: ben pjese ne trashegimine kulturore ende i pa deklaruar monument kulture por ne shqyrtim per t'u bere i mbrojtur.
- 66 Objekt unik: eshte nje veper arkitektonike ne perdorim te zakonshem ose me funksione artistike me zbulurime qe deri tani eshte identifikuar si i vetem ne trashegimine kulturore e materiale.
- 67 Park arkeologjik: eshte nje hapësire me nje vlere mjedisore ne te cilen mbrohen gremadhat e gjetura nga gremimet arkeologjike, nga ana e Shtetit.
- 68 Pashaporta e objektit: eshte kartela e identifikimit te nje objekti qe paraqet pasuri kulturore. Ne te vendosen foto, filma, skica, vendosja, pesha, materiali, madhesia, kodi i klasifikimit informatik, autori, pershkrimi dhe historia.
- 69 Qender arkeologjike: eshte hapësira ku mbrohen, mbi e nen/toke, monumentet dhe objektet me vlere arkeologjike.
- 70 Qender historike: eshte kompleksi urban i nje qyteti ose i nje vendi me vlere i mbrojtur nga Shteti.
- 71 Qytet -muze: eshte nje qender qyteti ose nje vend i mbrojtur nga Shteti.
- 72 Restaurim: eshte vleresimi i berthames origjinale te monumenteve nepermjet nderhyrjeve qe pengojne degradimin e metejshem, duke evidentuar vleren.
- 73 Statusi i objektit: eshte gjendja juridike e nje objekti.
- 74 Vlera arkeologjike: jane monumentet, banimet historike, objektet ose veprat e ndertuara ose te banueshme, te zbuluara nga gremimet arkeologjike, me vlere historike-kulturore
- 75 Zona arkeologjike: eshte siperfaqja ne te cilen gjenden monumentet e zbuluara nga gremimet arkeologjike dhe deshmon prezencen e stratigrafise me permbajtje historike.

- 76 Monumente kulturore te klasit 1°: ndertesa ose mbetje te dendura te strukturave qe i perkasin saktesisht nje horizonti historik kulturor te percaktuar, ku kuptohet funksioni origjinal, periudha, vlera, te gjykuara nga pamja mbi toke.
- 77 Monumente kulturore te klasi te 2°: ndertesa qe kane vlerave kulturore qe meritojne te mbrohen, per vecantine dhe karakteristikat thelbesore te rralla, por te nivelit me te ulet se ato te klasit te pare.
- 78 Rreziku arkeologjik: ka te beje me mundesine e takimit te mbetjeve arkeologjike te rendesishme e sinjifikative gjate germimeve ne ndertime
- 79 Germimet arkeologjike shkencore me shpenzimet e ndermarrjes: konsiston ne nje aktivitet germimi i shtrire ne te gjitha hapësirën e nderhyrjes, qe udhëhiqet nga esperte dhe sipas kriterëve shkencore, me shpenzimet e ndermarrjes pergjegjese per ndertimin.
- 80 Germim arkeologjik preventiv: konsiston ne nje aktivitet e germimi me kampione, te kryer nen drejtimin e eksperteve dhe sipas kriterëve shkencore, me shpenzimet e e ndermarrjes pergjegjese per ndertimin.
- 81 Kantieri i kontrolluar: lidhet me nje kusht te vecante te kantierit, qe i perket nje zone me rrezik te vogel arkeologjik, pergjegjesit e te cilit jane nen kontrollin e nje arkeologu, me shpenzimet e ndermarrjes pergjegjese per ndertimin.

Neni 3 Mbrojte

Deri ne aprovimin e Planit, jane pranuar vetem nderhyrjet e pershkrimeve te meposhtme, derisa nuk jane ne kundërshtim me normativat dhe mbikqyrjet e dhena ne normat e tanishme per cdo sistem, nensistem, pjese urbane elementare:

- nderhyrje te mirembajtjes se zakonshme, jashtezakonshme, rishendoshjes konservative dhe ristrukturimit ndertimor te ndertesave dhe strukturave ekzistuese. Keto nderhyrje nuk duhet te sjellin rritjen e siperfaqes se mbuluar e te siperfaqes se dobishme qe ka ekzistuar me pare, ndryshimin e destinacionit te perdorimit te ndertesës, rritjen e njesive te pasurise se paluejtëshme;
- nderhyrjet qe perfundojne me reduktimin e influences nga ndotjet, rrezikut hidraulik, prishjes hidrogjeologjike, ose rinatyalizimin e vendeve;
- transformimet e bimeve te lidhura me zhvillimin e aktivitetëve bujqesore;
- nderhyrjet e rikualifikimit dhe rikuperimit mjedisor panoramik, te lidhura dhe me zona te demtuara ose te braktisura qe kane te bejne me aktivitetë te industrise nxjerrëse.

Sidoqofte pranohen:

- a. nderhyrjet e bera nga entet publike dhe veprat me dobi e interes publik, te realizuara nga ente institucionalisht kompetente. Nderhyrje te tilla duhet te realizohen ne menyre qe te provokojne impaktin me te vogel te mundshem mjedisor;

- b. nderhyrjet qe rezultojne konform PRG ne fuqi dhe nuk jane ne kundershtim me disiplinen e Planit te ri, te percaktuar nga normat e tanishme urbanistike;
- c. nderhyrjet e parashikuara ne plan dhe marrveshjet tashme te aprovuara nga Administrata komunale dhe variantet e tyre qe behen te nevojshme me pas, per arsye te vertetuara, por pa asnje zgjerim te siperfaqeve ose volumeve, deri ne daten 15 dhjetor 2006, date e futjes ne fuqi te normave te tanishme te mbrojtjes.

Neni 4 Perpunime baze

Perbejne Planin e tanishem per zonen e qendres se Durresit:

- Q.1 Relacioni i pergjithshem.**
(fletore A4)
- Q.2 Norma te zbatimit**
(fletore A4)
- Q.3 Tabelat e Planit:**
(tabelat e formatit A0, shkalla 1 : 10.000 dhe te ndryshme)

Tab. 01 – Vizioni guide territoriale	1:10.000
Tab. 02 – Zona Qendrore e qytetit te Durresit (ACD). Percaktim	1: 5.000
Tab. 03 - ACD. Rregull i propozuar	1: 2.000
Tab. 04 - ACD. Densiteti rezidencial maksimalisht i pranueshem	1: 2.000
Tab. 05 - ACD. Standarte funksionale te projektit	1: 2.000
Tab. 06 - ACD. Sistemi i tuteles dhe vleresimit (Harta e qendrueshmerive) ¹	1: 2.000
Tab. 07 - ACD. Sistemi infrastrukturual dhe levizshmeria e qendrueshme	1: 2.000
Tab. 08 - ACD. Sistemi i qendrave te reja. Projekte strategjike	1: 2.000
Tab. 09 - ACD. Regjimi i transformimit	1: 2.000
Tab. 10 - ACD. Itinerare kulturore dhe turistike	1: 2.000

- Q.4 Album i projekteve strategjike** (mjediset e projektimit strategjik - MPS)
(fletorja format A3, shkalle te ndryshme)

APS 1 – Vija bregdetare lindore

- Tab. 1.1 Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
- Tab. 1.2 Aerofotogrametria – gjendja faktike, 2005

¹Tabela tregon dhe shkallen e rrezikut arkeologjik te vendosur nga Harta e Rrezikut Arkeologjik te Universitetit te Parmes. Te bashkengjitura gjendet vlerat normative te planit te tabelës 06, skedat identifikuese te vendeve arkeologjike dhe te zonave me interes historik, monumental dhe arkitektonik.

Tab. 1.3	Lartesite dhe profilet urbane - gjendja faktike
Tab. 1.4	Regjimi i pronesise dhe e perdorimit te truallit - gjendja faktike
Tab. 1.5	Siguri urbanistike
Tab. 1.6	Rrjete urbane dhe teknologjike - gjendja faktike
Tab. 1.7	Ndertesat dhe zonat me interes historik - gjendja faktike
Tab. 1.8	Degradimi - gjendja faktike
Tab. 1.9	Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
Tab. 1.10	Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
Tab. 1.11	Aseti i propozuar
Tab. 1.12	Drafte projektuese (plani volumetrik, treguesit material)
Tab. 1.13	Regjimi i trasformimit, standartet dhe treguesit urbanistik
Tab. 1.14	Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesa
Tab. 1.15	Kategorite e nderhyrjes /2 hapësira te pambuluara
Tab. 1.16	Treguesit dhe drafti i projektit

APS 2 – Projekti porti turistik moli jugor

Tab. 2.1	Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
Tab. 2.2	Aerofotogrametria - gjendja faktike, 2005
Tab. 2.3	Lartesite dhe profilet urbane - gjendja faktike
Tab. 2.4	Regjimie te pronesise dhe perdorimet e truallit - gjendja faktike
Tab. 2.5	Sigurite urbanistike
Tab. 2.6	Rrjete urbane e teknologjike - gjendja faktike
Tab. 2.7	Ndertesa dhe zona me interes historik - gjendja faktike
Tab. 2.8	Degradimi – gjendja faktike
Tab. 2.9	Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe ajo e propozuar.
Tab. 2.10	Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
Tab. 2.11	Aseti i propozuar
Tab. 2.12	Drafte projektuese (plani volumetrik, treguesit material)
Tab. 2.13	Regjimi i trasformimit, standarte dhe tregues urbanistik
Tab. 2.14	Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesat
Tab. 2.15	Kategorite e nderhyrjes /2 hapësirat e lira
Tab. 2.16	Treguesit dhe drafti i projektit

APS 3 – Projekti vija bregdetare jugore

Tab. 3.1	Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
Tab. 3.2	Aerofotogrametria - gjendja faktike, 2005
Tab. 3.3	Lartesite dhe profilet urbane - gjendja faktike
Tab. 3.4	Regjimi i pronesise dhe perdorimit te truallit - gjendja faktike
Tab. 3.5	Sigurite urbanistike
Tab. 3.6	Rrjete urbane e teknologjike - gjendja faktike
Tab. 3.7	Ndertesa dhe zona me interes historik - gjendja faktike
Tab. 3.8	Degradimi – gjendja faktike
Tab. 3.9	Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe ajo e propozuar..
Tab. 3.10	Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
Tab. 3.11	Aseti i propozuar
Tab. 3.12	Draft projektues (plani-volumetrik, treguesit material)
Tab. 3.13	Regjimi i trasformimit, standarte dhe tregues urbanistik
Tab. 3.14	Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesat

- Tab. 3.15 Kategorite e nderhyrjes /2 hapesirat e lira
- Tab. 3.16 Treguesit dhe drafti i projektit

APS 4 – Projekti Parku territorial i Mureve Bizantine dhe i Pallatit te Mbretit Zog

- Tab. 4.1 Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
- Tab. 4.2 Aerofotogrametria - gjendja faktike, 2005
- Tab. 4.3 Lartesite dhe profilet urbane - gjendja faktike
- Tab. 4.4 Regjimi i pronesise dhe e perdorimit te truallit - gjendja faktike
- Tab. 4.5 Sigurite urbanistike
- Tab. 4.6 Rrjete urbane e teknologjike - gjendja faktike
- Tab. 4.7 Ndertesa dhe zona me interes historik - gjendja faktike
- Tab. 4.8 Degradimi – gjendja faktike
- Tab. 4.9 Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe ajo e propozuar.
- Tab. 4.10 Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
- Tab. 4.11 Aseti i propozuar
- Tab. 4.12 Drafte projektuese (plani volumetrik, treguesit material)
- Tab. 4.13 Regjimi i transformimit, standarte dhe tregues urbanistik
- Tab. 4.14 Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesat
- Tab. 4.15 Kategorite e nderhyrjes /2 hapesirat e lira
- Tab. 4.16 Treguesit dhe drafti i projektit

APS 5 – Projekti i aksit urban Epidamn

- Tab. 5.1 Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
- Tab. 5.2 Aerofotogrametria - gjendja faktike, 2005
- Tab. 5.3 Lartesite dhe profilet urbane - gjendja faktike
- Tab. 5.4 Regjimi i pronesise dhe e perdorimit te truallit - gjendja faktike
- Tab. 5.5 Sigurite urbanistike
- Tab. 5.6 Rrjete urbane e teknologjike - gjendja faktike
- Tab. 5.7 Ndertesa dhe zona me interes historik - gjendja faktike
- Tab. 5.8 Degradimi – gjendja faktike
- Tab. 5.9 Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe ajo e propozuar.
- Tab. 5.10 Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
- Tab. 5.11 Aseti i propozuar
- Tab. 5.12 Drafte projektuese (planivolumetrik, treguesit material)
- Tab. 5.13 Regjimi i transformimit, standarte dhe tregues urbanistik
- Tab. 5.14 Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesat
- Tab. 5.15 Kategorite e nderhyrjes /2 hapesirat e lira
- Tab. 5.16 Treguesit dhe drafti i projektit

APS 6 – Projekti i aksit urban Stacioni hekurudhor – Parku i Rezistences

- Tab. 6.1 Kushtet aktuale dhe objektivat e projektit
- Tab. 6.2 Aerofotogrametria – gjendja faktike, 2005
- Tab. 6.3 Lartesite dhe profilet urbane – gjendja faktike
- Tab. 6.4 Regjimi i pronesise dhe e perdorimit te truallit- gjendja faktike

Tab. 6.5	Sigurite urbanistike
Tab. 6.6	Rrjete urbane e teknologjike – gjendja faktike
Tab. 6.7	Ndertesa dhe zona me interes historik – gjendja faktike
Tab. 6.8	Degradimi – gjendja faktike
Tab. 6.9	Sherbime dhe mjete kolektive, gjendja aktuale dhe ajo e propozuar.
Tab. 6.10	Levizshmeria dhe parkimi, gjendja aktuale dhe gjendja e propozuar.
Tab. 6.11	Aseti i propozuar
Tab. 6.12	Drafte projektuese (planivolumetrik, treguesit material)
Tab. 6.13	Regjimi i transformimit, standarte dhe tregues urbanistik
Tab. 6.14	Kategorite e nderhyrjes/1 ndertesat
Tab. 6.15	Kategorite e nderhyrjes /2 hapesirat e lira
Tab. 6.16	Treguesit dhe drafti i projektit

Q.5 Kuadri njohes

8.1 Harta njohese baze:

(tabela formati A0, shkalla 1 : 2.000, te permbledhura ne nje album format A3)

Tab. 01	– Foto ajrore rilevimi
Tab. 02	- Rilevimi aerofotogrametrik
Tab. 03	– Rikostruksioni i gjendjes faktike. Morfologjia e vendeve
Tab. 04	– Perdorimi i trojeve dominues dhe harta e pronesive publike
Tab. 05	– Ndertim ekzistuese, lartesine dhe periudha e ndertimit
Tab. 06	– Hapesirat publike dhe zonat e gjelberta
Tab. 07	– Levizshmeria
Tab. 08	– Rrjetet teknologjike urbane
Tab. 09	– Zonat arkeologjike dhe me interes historik dhe identitar
Tab. 10	– Zonat me rrezik hidrologjik, gjeologjik, sizmik
Tab. 11	– Degradimi urbanistik, degradimi ndertimor e higjieno – sanitar
Tab. 12	– aksione ne vazhdim
Tab. 13	– PRG ne fuqi
Tab. 14	– Kushte te tjera normative ne fuqi: pengesa dhe kufizime
Tab. 15	– Fotorilevimi i rrugeve kryesore

8.1 Kerkime gjeologjike (nen kujdesin e Zyres Teknike te Bashkise)

Harta gjeologjike
Harta gjeomorfologjike
Harta te terreneve te pjerreta
Harta litoteknike- te dhena baze
Harta hidrologjike
Harta hidrogjeologjike
Harta e rrezikshmerise hidraulike
Harta e pikave te dobeta te shtreses
Harta e rrezikshmerise gjeologjike

Gjithashtu jane bashkengjitur Kuadri Njohes i Planit per zonen e qendres se Duresit dhe studimet e meposhtme:

Q.6 Studime te sektorit: (fletoret A4)

- 6.1 Qyteti arkeologjik
- 6.2 Qyteti bizantin, venecian dhe otoman
- 6.3 Qyteti i nenteqintes
- 6.4 Morfologjite sociale e mireqenia
- 6.5 Levizshmerite, rrjetet, furnizimi energjistik urban dhe zhvillimi i qendrueshem
- 6.6 Qyteti, Porti, Zona metropolitane, Korridori VIII
- 6.7 Gjeologjia, rreziku hidrogjeologjik e Gjeoteknik
- 6.8 Problematikat strukturale dhe vleresimi i dobese se rrezikut sizmik

U jane te bashkelidhur gjithashtu studimeve te sektoreve te renditur, skedat identifikuese te trashegimise dhe te vendeve me interes arkeologjik, historik, monumental dhe arkitektonik

Q.7 Albumi i projekteve shtese

- PA.1 - Projekti i riintegrimit te qytetit me Portin
- PA 2 - Projekti i rikualifikimit te Pallatit te Kultures dhe te zonave arkeologjike per rreth.

Q.8 Plani i rikuperimit urban i bashkengjitur Planit te zones qendrore te Duresit

- 8.1 Plani i rikuperimit urban i zones se amfiteatrit roman (Universiteti i Parmes)

Neni 05

Kohezgjatja e Planit Urbanistik Integrimit per Qytetin e Vjeter te Duresit

Planit Urbanistik Integrimit per Qytetin e Vjeter te Duresit ka nje kohezgjatje prej pesembedhete vjetesh, duke filluar nga aprovimi i tij final.

TITULLI II – DREJTIME TE PERGJITHSHME BAZE, DIMENSIONIMET DHE KUSHTET E ZHVILLIMIT

Neni 06

Vizioni guide territoriale

1. Tabela 1 – vizioni guide territoriale, inkuadron percaktimin e propozuar nga Plani i Ri Durrësit, brenda nje strategjie komplekse, qe ka te beje me territorin bashkiak te qytetit ne te gjithë kompleksin e tij, duke evidentuar ndarjen e tij ne pjese, dhe duke dhene mundesine e rilidhjes se nevojshme zhvillimit dhe fuqizimin e korridoreve te mundshme te natyres mjedisore dhe infrastrukturale.

2. Ky imazh rinjeh 7 pjese territoriale te vecanta, secila e pajisur nga nje identitet i tij specifik, rol gjeografik dhe urban dhe funksione potenciale:

1. qyteti historik
2. qyteti i konsoliduar
3. qyteti i portit
4. qyteti industrial
5. parku territorial
6. qyteti turistik – bregdetar
7. qyteti informal i ultesires lagunore

3. Tabela e meposhtme identifikon ne forme sintetike rolet, funksioniet dhe rendesine superiore qe “qytetet” e ndryshme te Durrësit, jane detyruar ta marrin, ne kuadrin e nje riequilibri te ri territorial te te gjithë zones se urbanizuar.

<i>Pjeset</i>	<i>Roli territoriale</i>	<i>Kushtet aktuale</i>	<i>Dimensioni</i>	<i>Funksioni i propozuar nga Plani</i>
Qyteti historik	Qendra aktuale e sherbimeve tregetare dhe administrative te qytetit, seli e aktiviteteteve pritese	Qendra e qytetit	115 ha	Qendra e qytetit Perfaqesi Rezidenciale, turistike, politiko – administrative
Qyteti i konsoliduar	Zona dominante me funksion rezidencial	Zone gjysemqendore		Site te reja rezidenciale, tregetare dhe sherbimesh
Qyteti portual	Port i nivelit kombetar dhe nderkombetar	Zone e lidhur me funksionin e hyrjes, pritjes dhe transportit te mallrave dhe te pasagjereve ne tranzit		Aktivite lundrimi dhe sherbimesh, dhe te perspektives te sherbimeve urbane (pritese, kohe e lire)
Qytet industrial	Zone e lidhur ne te kaluaren me aktivite produktive, tani ne kerkim te nje fizionomie; nje hipoteze e pranueshme shikon te mundur perdorimin per funksione ekspozimi te lidhura me Korridrrin e VIII	Zone periferike, aktualisht ne grade te rende abandonimi, e interesuar nga fenomene te zenien ilegale (venbanime informale)		Zone e re e mundshme ekspozimi per ta lidhur me pjese te tjera urbane, ne vecanti me zonen qendrore te qytetit bregdetar, dhe me nje sistem te levizshmerise publike qe rikuperon transene e vjeter te hekurudhes industriale
Promontorio bregdetare	Perben gjithmone te vetmen mundesi per realizimin e nje parku te shtrire territorial	Vendosen lidhje te mundshme dhe hyrje nga zona qendrore dhe nga qytete te tjera te Durresit		Parku territorial natyralistik, me mundesine e shfrytezimit turistik spas rregullave
Qyteti turistik - kostier	Zona perdorimi balnear sezonal	Zone kryesisht e ndare nga qendra urbane		Zone per tu fuqizuar per sherbimet e turizmit, infrastruktures dhe rritjes se mundshme te residencave te qendrueshme, dhe te rilidhen morfologjikisht me qendren e qytetit
Qyteti informal	Zone kryesisht rezidenciale	Periferi ne gjendje te rende sociale dhe ekonomike		Zone per tu rikuperuar ne sensin urbanistik, ekonomik social dhe mjedisor

4. Tabela 1 – vizioni guide territoriale – identifikon pervec te tjerave struktura nderlidhese – infrastrukturale e mjedisore – te cilat lidhin ndermjet tyre pjese te ndryshme urbane te identifikuar.

5. Strukturat kryesore te nderlidhjes mjedisore jane te perbera nga:

1. nje korridor mjedisor bregdetar, ne te cilin detyra kryesore eshte ajo e krijimit te vazhdimesise mjedisore, ndermjet zonave bregdetare jugore – sot ne pjesen me te madhe te zena nga perqendrimet e reja me karakter turistik balnear – dhe e gjithë vija bregdetare urbane, deri ne kepën e Durrësit, tashme nje pjese e bere Park, dhe e destinuar te marre rolin e nje Parku te Madh Natyror. Ky korridor zhvillohet dhe shoqeron pjeserisht hekurudhen aktuale.
 2. nje korridor analog mjedisor i brendshem, ku funksioni eshte te lidhe zonat dominante natyrore te kodrave te brendshme (zona e Arapaj dhe e Rashbullit), duke kaluar nepermjet ultesires se brendshme sot te zene nga perqendrimet informale, te quajtur Park i kepit.
 3. nje rrjet minimal lidhjeje mjedisore, te projektuar duke u nisur nga nje rrjet hidrografik natyral dhe artificial ekzistent.
